



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1501/4 Prot

Tiranë, më 25.10.2022

VENDIM

Nr. 40, datë 25.10.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1501 Prot., datë 02.09.2022, (vijuar me shkresën nr. 1501/1 Prot., datë 07.09.2022), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Bashkia Tiranë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës datë 02.08.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, si më poshtë:

1. Sa është numri i pallateve të ndërtuara në territorin e Bashkisë Tiranë në funksion të procesit të rindërtimit?
2. Në cilat zona janë ndërtuar?
3. Cilat kanë qenë shoqëritë/kompanitë që kanë realizuar ndërtimin e tyre?
4. Sa ka qenë kostoja e ndërtimit për secilin pallat?
5. Kopje të procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve;
6. Kopje të kontratave të lidhura me shoqëritë/kompanitë për ndërtimin e pallateve;
7. Cilat kanë qenë studiot që kanë realizuar projektet për këto pallate?
8. Kopje të kontratave të lidhura me studiot të cilat kanë realizuar projektin e pallateve.

Autoriteti Publik, nëpërmjet koordinatores për të drejtën e informimit, me e-mail-in datë 03.08.2022 ka informuar kërkuuesin se kërkesa e paraqitur nga ana juaj është protokolluar dhe se ka kaluar për trajtim pranë strukturave përkatëse.

Ankuesi, pas përgjigjes së Autoritetit Publik, dhënë me shkresën Nr. Q-18086/5 Prot., datë 01.09.2022, pretendon se i është kthyer përgjigje për tre pikat e para të kërkesës për informacion. Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, i është drejtuar Zyrës së Komisionerit me ankesë, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, për pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8 të kërkesës për informacion.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjëndje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Zyra e Komisionerit, me shkresën nr. 1501/2 prot., datë 08.09.2022, ka kërkuar qëndrimin e Autoritetit Publik, në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 14.09.2022, ka kthyer përgjigje duke sqaruar ndër të tjera se: “*Në zbatim të Vendimit Nr. 533, datë 22.9.2021, për shpronësimin për interes publik, në funksion të procesit të Rindërtimit për zhvillimin e zonës së re, në përputhje me Planin e Detyruar Vendor, përmes kompensimit me shkëmbim, për të gjitha pasuritë që preken nga realizimi i projektit “Për zonën e re për zhvillim në njësitë administrative 4 dhe 8, zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë”, nga verifikimi i kryer nga ana jonë në sistemin elektronik E-leje, rezulton se me vendimet Nr. T-29416/4, dt.10.02.2022 dhe Nr. T-475/4, dt.12.04.2022 të Kryetarit të Bashkisë janë miratuar lejet e ndërtimit për shpalljen e re për zhvillim Njësia Administrative 4 dhe 8, Zona “5 Maji”, Bashkia Tiranë”.*

Gjithashtu, në vijim, me shkresën nr. Q-18086/8 Prot., datë 22.09.2022 të koordinatores për të drejtën e informimit pranë autoritetit publik, i ka kthyer përgjigje ankuesit me arsyetimin si vijon: “*Me shkresën me nr. prot. Q-18086/7, datë 22.09.2022 të Zëvendëskryetarit z. është kthyer përgjigje me argumentin: Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Tiranë me shkresën me nr. prot. Q-18086/5, datë 01.09.2022, ju ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar në kuadër të procesit të rindërtimit.*

Përsa i përket pikës 5 të kërkesës suaj, në të cilën kërkohet kopje e procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve, ju bëjmë me dije se ky infomacioni është i diponueshëm në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Procedurat e prokurimit në kuadër, të procesit të rindërtimit janë zhvilluar me mjete elektronike, dhe njoftimet përkatëse lidhur me procesin e vlerësimit, shpalljen fitues, lidhjen e kontratave, kontraktorët përkatës, janë të aksesueshëm në buletinët e Posaçëm të Agjencisë së Prokurimit Publik. Përsa më sipër ju bëjmë me dije

se, nëse ju duhen dokument shtesë, fillimisht duhet të kryeni pagesën mbi tarifën për dhënie të informacionit dhe/ose vënien në dispozicion të dokumentave të prodhuara nga Bashkia Tiranë, referuar nenit 55 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 158 datë 26.12.2019 “Për miratimin e sistemit të taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar).

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar ankimin regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1501/3 Prot., datë 27.09.2022, duke rikonfirmuar qëndrimin e reflektuar në ankesë, si dhe duke sqaruar se: *“Në përgjigjen e tij, autoriteti publik, na referon marrjen e informacionit në web, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, duke mos vënë në dispozicion linqet përkatëse të secilës procedurë.(lidhur me pikën 5 të kërkesës). Ndërkohë nuk na informon në lidhje me pikat e tjera të kërkesës...”*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga Autoriteti Publik, nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Bazuar në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*.

Në kuptim të këtij parashikimi, Bashkia Tiranë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës lidhet me procesin e rindërtimit nga tërmeti, si dhe me procedura prokurimi në kuadër të këtij procesi, të zhvilluara nga Autoriteti Publik, që i nënshtrohet gjithashtu dispozitave të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar (ligji i zbatueshëm në atë periudhë), si dhe ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Në lidhje me pretendimin e ngritur nga Autoriteti Publik se, informacioni i kërkuar, konkretisht për pikën 5 të kërkesës për informacion, *kopje e procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve,* është i diponueshëm në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Në përgjigjen e dhënë, konstatohet se Autoriteti Publik ka orientuar faqen zyrtare të institucionit, ku pretendon se është publikuar informacioni dhe jo adresën e saktë të tij, në mënyrë të tillë që informacioni të gjendet lehtësisht nga kërkuesi.

Ky qëndrim i Autoritetit Publik nuk vjen në përputhje me parashikimet e pikës 2 të nenit 16 të LDI, në të cilën parashikohet se: *“Kur informacioni kërkohet në format elektronik dhe ai gjendet në internet, autoriteti publik i tregon menjëherë kërkuesit adresën e saktë të faqes se ku mund të gjendet informacioni...”*. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik për vendosjen në dispozicion të informacionit të kërkuar, duhet t'i tregojë ankuesit adresën e saktë në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në të cilën gjendet informacioni i kërkuar.

Gjithashtu, pika 1 dhe 2 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, përcakton se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi. 2. Autoriteti ose enti kontraktor administron të gjithë dokumentacionin për procedurën e prokurimit, duke filluar nga planifikimi deri te zbatimi i kontratës, me qëllim kontrollin e zbatimit të ligjit”*.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i plotë i procedurave të prokurimit, administrohet nga vetë autoriteti kontraktor, që ka zhvilluar këto të fundit. Fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimit publik është të sigurojë integritet, besim në publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura.

Për sa më sipër, informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse ai është i prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të LDI, ku përcaktohet se: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuesit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*.

Gjithashtu, theksojmë se, bazuar në gjurmën e), pika 1, të nenit 7 të LDI dhe Urdhrit nr.187 datë 18.12.2020 “Për miratimin e Programit të Transparencës të Rishikuar” i ndryshuar, të Komisionerit, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit, që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Konkretisht, dispozita e sipërcituar përcakton se: *“Në përputhje me programin e transparencës së miratur për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht,*

në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit.... ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/ partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik privat, duke përfshirë:

- i. listën e kontratave të lidhura;*
- ii. shumën e kontraktuar;*
- iii. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;*
- iv. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Për sa më sipër, Autoriteti Publik në përputhje me dispozitën e sipërcituar duhet të kishte trajtuar kërkesën për informacion, në kushtet kur një pjesë e informacionit të kërkuar rezulton publik në mënyrë proaktive në programin e tij institucional të transparencës.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 3 të LDI, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 1501 Prot., datë 02.09.2022, nga Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik, "Bashkia Tiranë", me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 02.08.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", konkretisht për pikat: ("*- 4. Sa ka qenë kostoja e ndërtimit për secilin pallat? - 5. Kopje të*

procedurave të tenderit/tenderave për shpalljen fitues të shoqërive/kompanive për ndërtimin e pallateve; - 6. Kopje të kontratave të lidhura me shoqëritë/kompanitë për ndërtimin e pallateve; - 7. Cilat kanë qenë studiot që kanë realizuar projektet për këto pallate? - 8. Kopje të kontratave të lidhura me studiot të cilat kanë realizuar projektin e pallateve.”), brenda datës 01.11.2022.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 25.10.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

